



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2030/4 prot

Datë 29.08.2023

V E N D I M
Nr. 824/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri
Fiorent Zguro
Anila Malaj

Kryetar
Nënkryetar
Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.08.2023 me

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga BOE “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK & “Elektrosek” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-74132-07-03-2023 me objekt: “SERVER + STORAGE NAS PËR SISTEMET E VËZHGIMIT”, me fond limit 19,975,062 lekë pa TVSH, zhvilluar me date 20.07.2023 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.

Autoriteti Kontraktor: ILLYRIAN GUARD SH.A
Adesa: Rruga “Ibrahim Rugova”, Tiranë 1016

Ankimues: BOE “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK & “Elektrosek” SHPK
Adresa: Rruga e Kavajës, kompleksi “Square 21”, sh.2,k.9 me nr. pasurie 1/710+2-30

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni

4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.07.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-74132-07-03-2023 me objekt: “SERVER + STORAGE NAS PËR SISTEMET E VËZHGIMIT”, me fond limit 19,975,062 lekë pa TVSH, zhvilluar me date 20.07.2023 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.

II.2. Në datën 14.08.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “BNT ELECTRONICS” SHPK	12,963,000 lekë, skualifikuar
2. “Divitech” SHPK	18,449,500 lekë, skualifikuar
3. “Real Com” SHPK	18,462,600 lekë, skualifikuar

4. “BOE “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)”
SHPK & “Elektrosek” SHPK 18,888,888 lekë, skualifikuar

II.3. BOE “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK & “Elektrosek” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

1.1 Në Serverin e ofertuar në broshurën e serverit nuk ka të përcaktuar kartën grafike e cila në tabelën e specifikimeve teknike SERVER pika (d) kërkohet min 24GB e dedikuar Gen4 ose më e mirë. Në të njëjtën pike janë kërkuar min. 3 porta të cilat mund të jenë DVI, HDMI, DP, mDP, porta të cilat nuk janë të përcaktuara në Serverin e ofertuar nga OE.

1.2 Në Serverin e ofertuar nga OE nuk është shprehur për pikën (e) të specifikimeve SERVER ku kërkohet -Min.1 External USB DVD-RË Optical Disk Drive.

1.3 Në specifikimet teknike Server pika (f) ku kërkohet- Min. 2X1600Ë (230V) hot-sëap nuk është përcaktuar voltazhi i poëer supply 230 V.

1.4 Në specifikimet teknike Server USB pika (h) ku kërkohet- Min 4x porta nga të cilat 2x të jenë porta 3.0 në modelin e ofertuar nga OE nuk është e përcaktuar portat USB .

1.5 Në specifikimet Storage NAS pika (b) Performanca ku kërkohet- Regjistrimi në video Min. (2 Mbps) 600-ch recording + playback në Storage e ofertuar nga OE nuk përmbush funksionalitetin e playback.

1.6 Nga kontrolli në faqen zyrtare te HIK VISION, <https://ëë.hikvision.com/europe/products/IP-Products/Storage/ClusterStorage/DS-A83048S-ICVS/>, per performancen e Storage te ofertuar DS-A83048S-ICVS pershkruhet se Performanca e ketij storage eshte Standard Cluster (2 Mbps) 430-ch gje qe bie ne kundershtrim me kerkesat ne specifikime teknike ku kerkohet min Min. (2 Mbps) 600-ch.

1.7 Ne Specifikimet teknike Server pika (g) ku eshte kerkuar- PCIe 10Gb 2-Port SFP + Ethernet Adapter ne serverin e ofertuar nuk ka porta PCIe 10Gb SFP+Ethernet adapter.

1.8 Ne specifikimet teknike Server pika (i) VGA ku kerkohet - Min nje porte VGA, modeli i ofertuar nga OE nuk percakton nje porte te tille ne broshuren e Serverit te ofertuar. Operatori ekonomik nuk plotëson specifikimet teknike.

II.4. Në datën 15.08.2023, autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit.

II.5. Në datën 21.08.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2030 prot. e BOE “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK & “Elektrosek” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.2030/2 prot., datë 22.08.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit të BOE “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK & “Elektrosek” SHPK.

II.7. Njëpërmjet shkresës me nr. 895/33 prot., datë 28.08.2023, protokolluar me tonën me nr. 2030/3 prot., datë 29.08.2023, me lëndë “Dërgim vendimi”, mbi numri i protokollit 2030/2023, data e protokollit 2023-08-21 paraqitur pranë autoritetit kontraktor “Illyrian Guard” S.H.A me nr. 895/30 prot., datë 21.08.2023 dërguar nga operatori ekonomik “I.S.S Integrated Smart Solutions” SHPK përfaqësues i BOE) Elektrosek shpk (anëtar BOE)” është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “BOE “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK & “Elektrosek” SHPK dhe me shkresën nr. 895/33 prot., datë 28.08.2023, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës, konkretisht citoj:
“[...]

KSHA shprehet se:

Në dokumentin “DataShet” e paraqitur ku jepen konfigurimet e zgjidhjes së qendrës e cila është përpiluar në fuqen zyrtare të kompanisë **Lenovo**, emri broshurës “datashet” të ngarkuar është **Teknike server** numri i pjesës “**A2SE dhe S6556**” me përshkrim produkti **Thinksystem A30 NVIDIA 24 GB, Gen 4** dhe lehtësisht e verifikueshme në faqen zyrtare të <https://www.nvidia.com>

✓ **Ky specifikim plotëson kriteret.**

2. Në serverin e ofertuar nga OE nuk është shprehur për pikën e specifikimeve SERVER ku kërkohet- Min 1 EXTERNAL USB DVD RË Optical disc drive, pajisja e ofertuar e modelit LENOVO Think System SR 650 nuk ka portat usb të nevojshme për të mundësuar lidhjen me minimum 1 pajisje të jashtme.

KSHA shprehet se:

Pas konsultimit të **katalog_server**, **teknik_server** edhe në faqen www.lenovo.com, [thinksystem](http://thinksystem.com), <https://lenovopress.lenovo.com/lp1050-thinksystem-sr650-server>, ksha shprehet se serveri mundëson lidhjen me EXTERNAL USB DVD RË Optical disc drive ku OE e ka paraqitur me deklaratën për plotësimin e SP Teknike dhe linkun me serverin që e mundëson këtë opsion.

✓ **Ky specifikim plotëson kriteret**

3. Në specifikimet teknike server nuk është përcaktuar voltazhi i poëer supply 230 V 2x 1600 w.

KSHA shprehet se:

Në dokumentin e paraqitur nga OE “**Katalog_server**” ku jepen qartë konfigurimet e zgjidhjes së qendrës me përshkrim:

Power (energy Star 2.0 compliant 2x hot swap 1600 w80 Plus Platium:

Specifications

Form Factor/Height	2U-rack server
Processors	Up to 2 second-generation Intel® Xeon® Platinum processors, up to 205W
Memory	Up to 7.5TB in 24x DIMM slots using 128GB DIMMs and Intel® Optane™ DC Persistent Memory; 2666MHz / 2933MHz TruDDR4
Expansion Slots	Up to 7x PCIe 3.0 via multiple riser options, including 1x dedicated PCIe slot for RAID adapter
Drive Bays	Up to 14x 3.5" or up to 24. 2.5" hot-swap bays (up to 12 AnyBay bays or up to 24 NVMe bays); up to 2x M.2 boot drives (RAID 1)
HBA/RAID Support	HW RAID (up to 24 ports) with flash cache; up to 16-port HBAs
Security and Availability Features	TPM 1.2/2.0; PFA; hot-swap/redundant drives, fans, and PSUs; 45°C continuous operation; light path diagnostic LEDs; front-access diagnostics via dedicated USB port
Network Interface	2/4-port 1GbE LOM; 2/4-port 10GbE LOM (Base-T or SFP+); 1x dedicated 1GbE management port
Power (Energy Star 2.0 compliant)	2x hot swap/redundant: 550W/750W/1100W/1600W 80 PLUS Platinum; or 750W 80 PLUS Titanium; or - 48V DC 80 PLUS Platinum

....

✓ **Ky specifikim plotëson kriteret.**

4.Në specifikimet teknike server USB pika (h) ku kërkohet – Min 4x porta nga të cilat 2 x të jenë porta 3.0...në modelin e ofertuar nga OE nuk është e përcaktuar portat USB

KSHA shprehet se:

Referuar “datasheetit” dhe katalog_server, teknike_server pajisja e ofertuar disponon portat e kërkuara USB, pas konsultimit edhe në faqen www.lenovo.com thinksystem, <https://lenovopress.lenovo.com/lp1050-thinksystem>,

✓ **Ky specifikim plotëson kriteret.**

5.Në specifikimet Storage NAS 600-ch recording+playback, në storage e ofertuar nga OE nuk përmbush funksionalitetin e playback.

KSHA shprehet se:

Storage i ofertuar nga OE përmbush specifikimin teknike për 600 kanale regjistruese. Funksionaliteti playback nënkupton procesin e riprodhimit të të dhënave të regjistruara. Pra nëse pajisja bën regjistrim detyrimisht ka dhe funksionalitetin playback pasi ky është qëllimi për të cilin është krijuar.

✓ **Ky specifikim plotëson kriteret.**

6.Nga kontrolli në faqen zyrtare të www.hikvision.com përshkruhet se performanca e atij storage është standart Cluster (2MBPS) 430 ch gjë që bie në kundërshtim me kërkesat në specifikime teknike ku kërkohet min 2mbps 600-ch.

KSHA shprehet se:

Pajisja e ofertuar DS-A830XXs-ICVS pas konsultimit të katalogut “datashet” ngarkuar në sistem të emëruar katalog storage,

Specification

Model	DS-A83024S-ICVS	DS-A83048S-ICVS
Performance	Standard cluster (2 Mbps)	600-ch

Dhe prodiktin në faqen zyrtare të kompanisë www.hikvision.com rezulton se është standart Cluster (2MBPS)-600ch.

✓ **Ky specifikim plotëson kriteret.**

7.Në specifikimet teknike server pika (i) VGA ku kërkohet – min një portë VGA, modeli i ofertuar nga OE nuk përcakton një portë të tillë në broshurën e serverit të ofertuar.

KSHA shprehet se:

Referuar datasheet pajisja e ofertuar disponon portën e kërkuar VGA, pas konsultimit me “datasheet” katalog_server, teknike_server edhe në faqen www.lenovo.com të ngarkuar në katalogu i serverit, <https://lenovopress.lenovo.com/lp1050-thinksystem-sr650-server>

✓ **Ky specifikim plotëson kriteret.**

8.Në specifikimet teknike serverpika (g) ku është kërkuar -PCIe 10GB 2 Port SFP+Ethernet adapter.

Ksha shprehet se:

Referuar “datasheetit” ky specifikim plotësohet tek ndërfaqja e rrjetit ku pajisja e ofertuar disponon minimalisht 2 porta10GB SFP+. Pas konsultimit të ngarkuar në katalogun e serverit **katalog_server, teknike_server** si dhe në faqen www.lenovo.com <https://lenovopress.lenovo.com/lp1050-thinksystem-sr650-server>

✓ **Ky specifikim plotëson kriteret**

KSHA vlerëson se operatori ekonomik ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin në përputhje në kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, Gjithashtu operatori ekonomik plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE VENDOSI:

1. Të pranojë ankesën e OE: “I.S.S Integrated Smart Solutions” SHPK përfaqësues i BOE) Elektrosek shpk (anëtar BOE) [...].

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e BOE “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK & “Elektrosek” SHPK dhe me shkresën nr. 2030/3 prot., datë 29.08.2023, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës, konkretisht citoj:

“[...]”

KSHA shprehet se:

Në dokumentin “DataShet” e paraqitur ku jepen konfigurimet e zgjidhjes së qendrës e cila është përpiluar në fuqen zyrtare të kompanisë Lenovo, emri broshurës “datashet” të ngarkuar është Teknike server numri i pjesës “A2SE dhe S6556” me përshkrim produkti Thinksystem A30 NVIDIA 24 GB, Gen 4 dhe lehtësisht e verifikueshme në faqen zyrtare të <https://www.nvidia.com>

✓ **Ky specifikim plotëson kriteret.**

2. Në serverin e ofertuar nga OE nuk është shprehur për pikën e specifikimeve SERVER ku kërkohet- Min 1 EXTERNAL USB DVD RË Optical disc drive, pajisja e ofertuar e modelit LENOVO Think System SR 650 nuk ka portat usb të nevojshme për të mundësuar lidhjen me minimum 1 pajisje të jashtme.

KSHA shprehet se:

Pas konsultimit të katalog_server, teknik_server edhe në faqen www.lenovo.com, thinksystem, <https://lenovopress.lenovo.com/lp1050-thinksystem-sr650-server>, ksha shprehet se serveri mundëson lidhjen me EXTERNAL USB DVD RË Optical disc drive ku OE e ka paraqitur me deklaratën për plotësimin e SP Teknike dhe linkun me serverin që e mundëson këtë opsion.

✓ **Ky specifikim plotëson kriteret**

3. Në specifikimet teknike server nuk është përcaktuar voltazhi i power supply 230 V 2x 1600 ë.

KSHA shprehet se:

Në dokumentin e paraqitur nga OE “Katalog_server” ku jepen qartë konfigurimet e zgjidhjes së qendrës me përshkrim:

Poëer (energy Star 2.0 compliant 2x hot sëap 1600 w80 Plus Platium:

Specifications	
Form Factor/Height	2U rack server
Processors	Up to 2 second-generation Intel® Xeon® Platinum processors, up to 205W
Memory	Up to 7.5TB in 24x DIMM slots using 128GB DIMMs and Intel® Optane™ DC Persistent Memory; 2666MHz / 2933MHz TruDDR4
Expansion Slots	Up to 7x PCIe 3.0 via multiple riser options, including 1x dedicated PCIe slot for RAID adapter
Drive Bays	Up to 14x 3.5" or up to 24. 2.5" hot-swap bays (up to 12 AnyBay bays or up to 24 NVMe bays); up to 2x M.2 boot drives (RAID 1)
HBA/RAID Support	HW RAID (up to 24 ports) with flash cache; up to 16-port HBAs
Security and Availability Features	TPM 1.2/2.0; PFA; hot-swap/redundant drives, fans, and PSUs; 45°C continuous operation; light path diagnostic LEDs; front-access diagnostics via dedicated USB port
Network Interface	2/4-port 1GbE LOM; 2/4-port 10GbE LOM (Base-T or SFP+); 1x dedicated 1GbE management port
Power (Energy Star 2.0 compliant)	2x hot swap/redundant: 550W/750W/1100W/1600W 80 PLUS Platinum; or 750W 80 PLUS Titanium; or - 48V DC 80 PLUS Platinum

....

✓ **Ky specifikim plotëson kriteret.**

4.Në specifikimet teknike server USB pika (h) ku kërkohet – Min 4x porta nga të cilat 2 x të jenë porta 3.0...në modelin e ofertuar nga OE nuk është e përcaktuar portat USB

KSHA shprehet se:

Referuar “datasheetit” dhe katalog_server, teknike_server pajisja e ofertuar disponon portat e kërkuara USB, pas konsultimit edhe në faqen www.lenovo.com thinksystem, <https://lenovopress.lenovo.com/lp1050-thinksystem>,

✓ **Ky specifikim plotëson kriteret.**

5.Në specifikimet Storage NAS 600-ch recording+playback, në storage e ofertuar nga OE nuk përmbush funksionalitetin e playback.

KSHA shprehet se:

Storage i ofertuar nga oE përmbush specifikimin teknike për 600 kanale regjistruese. Funksionaliteti playback nënkupton procesin e riprodhimit të të dhënave të regjistruara. Pra nëse pajisja bën regjistrim detyrimisht ka dhe funksionalitetin playback pasi ky është qëllimi për të cilin është krijuar.

✓ **Ky specifikim plotëson kriteret.**

6.Nga kontrolli në faqen zyrtare të www.hikvision.com përshkruhet se performanca e atij storage është standart Cluster (2MBPS) 430 ch gjë që bie në kundërshtim me kërkesat në specifikime teknike ku kërkohet min 2mbps 600-ch.

KSHA shprehet se:

Pajisja e ofertuar DS-A830XXs-ICVS pas konsultimit të katalogut “datasheet” ngarkuar në sistem të emëruar katalog storage,



Specification		
Model	DS-A83024S-ICVS	DS-A83048S-ICVS
Performance	Standard cluster (2 Mbps)	600-ch

Dhe produktin në faqen zyrtare të kompanisë www.hikvision.com rezulton se është standart Cluster (2MBPS)-600ch.

✓ **Ky specifikim plotëson kriteret.**

7.Në specifikimet teknike server pika (i) VGA ku kërkohet – min një portë VGA, modeli i ofertuar nga OE nuk përcakton një portë të tillë në broshurën e serverit të ofertuar.

KSHA shprehet se:

Referuar datasheet pajisja e ofetuar disponon portën e kërkuar VGA, pas konsultimit me “datasheet” katalog_server, teknike_server edhe në faqen www.lenovo.com të ngarkuar në katalogu i serverit, <https://lenovopress.lenovo.com/lp1050-thinksystem-sr650-server>

✓ **Ky specifikim plotëson kriteret.**

8.Në specifikimet teknike serverpika (g) ku është kërkuar -PCIe 10GB 2 Port SFP+Ethernet adapter.

Ksha shprehet se:

Referuar “datasheetit” ky specifikim plotësohet tek ndërfaqja e rrjetit ku pajisja e ofetuar disponon minimalisht 2 porta10GB SFP+. Pas konsultimit të ngarkuar në katalogun e serverit katalog_server, teknike_server si dhe në faqen www.lenovo.com <https://lenovopress.lenovo.com/lp1050-thinksystem-sr650-server>

✓ **Ky specifikim plotëson kriteret**

KSHA vlerëson se operatori ekonomikka dorëzuar të gjithë dokumentacionin në përputhje në kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, Gjithashtu operatori ekonomik plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE VENDOSI:

2. Të pranojë ankesën e OE: “I.S.S Integrated Smart Solutions” SHPK përfaqësues i BOE) Elektrosek shpk (anëtar BOE) [...].

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga

operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente në cilësinë e subjektit të interesuar në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në autoritetin kontraktor, (referuar kjo informacionit të autoritetit kontraktor të dërguar në KPP) dhe as në Komisionin e Prokurimit Publik.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konkretisht aktit të trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimes, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën e BOE “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK & “Elektrosek” SHPK, kështu që rrjedhimisht, për sa kohë nuk janë paraqitur argumente nga subjektet e interesuara, Komisioni në mbështetje të nenit 115 pika 3 gërma a), mbyll çështjen për ankesën e paraqitur nga BOE “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK & “Elektrosek” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga BOE “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK & “Elektrosek” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-74132-07-03-2023 me objekt: “SERVER + STORAGE NAS

PËR SISTEMET E VËZHGIMIT”, me fond limit 19,975,062 lekë pa TVSH, zhvilluar me date 20.07.2023 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
 3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK & “Elektrosek” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri